

**AKT-THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQERISE TREGTARE "Gashi Packaging Service" SH.P.K.**

Ne baze te ligjit nr 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" dhe ne zbatim me ligjin nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", ligjit nr 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin 9901 date 14/04/2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare " te ndryshuar , sot **ne daten 12/12/2024** behet themelimi i shoqerise "**Gashi Packaging Service" SH.P.K** me seli ne **ELBASAN, Bradashesh, Ish Kombinati Metalurgjik, prane uzines nr.12, zk.3965 pasuria nr.432/3.**

nga ortaku i kesaj Shoqerie **Z.Arlindi Gashi** i pajisur me pasaporte gjermane  
**nr.C16KJVT1J**

**VENDOSIN**

Te krijojne nje Shoqeri Tregtare te emertuar "**Gashi Packaging Service" SH.P.K** me kushtet e meposhtme:

**NENI 1**

Themeluesi ne cilesine e ortakut krijojn shoqerine tregtare "**Gashi Packaging Service" SH.P.K** me statusin juridik te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ne kuptimin e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ligjit 129/2014, me mjetet e veta financiare duke paguar kontributin ne para.

**NENI 2**

Shoqeria gezon statusin e personit juridik dhe veprimtaria e saj do te rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi, nga ky Akt-Themelimi dhe statutin e bashkelidhur.

**NENI 3**

Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj me emertimin "**Gashi Packaging Service" SH.P.K** emer ky qe do te shenohet ne te gjitha dokumentat, letrat, faturat etj. Ajo ka vulen e saj ne te cilen eshte shkruar "**Gashi Packaging Service", SH.P.K,** **Elbasan, Albania.**

#### NENI 4

Shoqeria e ka seline e saj ne:

**ELBASAN Bradashesh, Ish Kombinati Metalurgjik, prane uzines nr.12, zk.3965 pasuria nr.432/3**

Ajo mund te hape perfaqesi, dege ose filiale edhe ne qytete te tjera te Shqiperise.

#### NENI 5

Afati i veprimtarise se Shoqerise do te jete i pakufizuar, me perjashtim te rastit kur ortakët vendosin prishjen e saj.

#### NENI 6

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj me objekt :

- **Import-eksport**
- **Prodhim, perpunim, tregtim me shumice/pakice te produkteve plastike qe perdoren per paketime/amballazhime te ushqimeve.**
- **Transport per nevojat e aktivitetit.**

**Dhe cdo aktiviteti tjeter te nevojshem lidhur me objektin e veprimtarise ne perputhje me legjislacionit Shqipetar.**

#### NENI 7

Me vendimin e themeluesit te saj, shoqeria mund te ndryshoje emrin, seline, formen juridike dhe objektin e veprimtarise, mbas berjes se ndryshimeve perkatese ne statut dhe ne kete akt themelimi.

#### NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise perfaqeson kontributet ne para dhe eshte **100.000** (njqindmije) leke shqiptare.

Ortaku Z.Arlindi Gashi i pajisur me pasaporte gjermane nr.C16KJVT1J zoteron **nje kuote me vlere 100.000 leke ose 100 % te kapitalit themeltar.**

#### **NENI 9**

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitime. Ajo eshte pergjegjese per detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe personave te tjere.

#### **NENI 10**

Shoqeria zhvillon veprimtarine e saj administruese, ekonomike, financiare ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi dhe dispozitat e statutit bashkelidhur.

Shoqeria do te drejtohet nga organet drejtuese qe perbehen nga asambleja e ortakeve dhe administratori. Themeluesit me vendim te veçante do te emerojne dhe nje ekspert kontabel. Shoqeria do te mbaje llogarite ne perputhje me ligjin, " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare", si dhe do te krijoje fondin rezerve.

Fitimi neto qe do te rezultoje ne fund te cdo viti financiar pas zbritjes se fondit rezerve dhe humbjeve te mbajtura nga vitet e meparshme do ti kaloje ortakeve.

#### **NENI 11**

Percaktimi i struktures organizative te shoqerise, numri i punonjesve dhe emerimet e shkarkimet ne organet e saj behen me vendim te asamblese se ortakeve. Administrator i Shoqerise **Z.Arlindi Gashi i pajisur me pasaporte gjermane nr.C16KJVT1J**

Maredheniet e punes do te bazohen ne kontratat e punes te lidhura mbi bazen e legjislacionit ne fuqi.

#### **NENI 12**

Rregullat per drejtimin, organizimin dhe prishjen e shoqerise jane percaktuar ne statutin qe i bashkelidhet ketij Akt-Themelimi.

### **THEMELUESIT E SHOQERISE TREGTARE**

**"Gashi Packaging Service" SH.P.K.**  
**Z.Arlindi Gashi**

